



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1610/20 prot.

Datë 29.08.2024

V E N D I M
Nr. 1143 /2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.08.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1028/2024, datë 12.08.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-09064-06-11-2024, me objekt: **“Loti I “Materiale Kancelarie me bazë letre”**”, me fond limit 736,606.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.06.2024, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK me NIPT J72124001N, me adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, km.10, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
Blv.“Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 12.08.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1028/2024, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "Marketing & Distribution" SHPK, për procedurën e prokurimit "E hapur, e thjeshtuar", me Nr. REF-09064-06-11-2024, me objekt: "Loti I "Materiale Kancelarie me bazë letre"", me fond limit 736,606.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 12.06.2024, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "Marketing & Distribution" SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet dhe arsyetimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.

4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ti propozojë Autoritetit të Konkurrencës nisjen e hetimit administrativ sipas konstatimeve të mësipërme.

6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues Marketing & Distribution" SHPK.

7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 499/28 prot., datë 15.08.2024, protokolluar me tonën nr. 1610/17 prot., datë 16.08.2024, autoriteti kontraktor, njofton se: "Në zbatim të vndimit nr.1028/2024, me nr. 1610/15 prot., datë 12.08.2024 me lëndë, të KPP-së, protokolluar me tonën 499/27, datë 15.08.2024, ju bëjmë me dije sa më poshtë vijon: Operatori Qëndror Blerës, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, ka bërë ndryshimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi për objektin me numër reference REF-09064-06-11-2024, me objekt: "Loti I "Materiale Kancelarie me bazë letre"", me fond limit 736,606.00 lekë pa TVSH. Ndryshimet janë bërë edhe në sistemin elektronik të prokurimit publik me datë 15.08.2024.

Bashkëlidhur:

-Formulari për ndryshimin e dokumentave të tenderit dhe shtojca datë 15.08.2024".

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën nr. 499/28 prot., datë 15.08.2024, protokolluar me tonën nr. 1610/17 prot., datë 16.08.2024, autoriteti kontraktor, njofton se: "Në zbatim të vndimit nr.1028/2024, me nr. 1610/15 prot., datë 12.08.2024 me lëndë, të KPP-së, protokolluar me tonën 499/27, datë 15.08.2024, ju bëjmë me dije sa më poshtë vijon: Operatori Qëndror Blerës, Operatori i Blerjeve të

Përqëndruara, ka bërë ndryshimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi për objektin me numër reference REF-09064-06-11-2024, me objekt: "Loti I "Materiale Kancelarie me bazë letre"", me fond limit 736,606.00 lekë pa TVSH. Ndryshimet janë bërë edhe në sistemin elektronik të prokurimit publik me datë 15.08.2024.

Bashkëlidhur:

-Formulari për ndryshimin e dokumentave të tenderit dhe shtojca datë 15.08.2024".

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka modifikuar dokumentat e tenderit, nëpërmjet një shtojce për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, dhe e ka publikuar, e cila është në përputhje me vendimin Nr. 1028/2024, datë 12.08.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor Autoriteti i Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, ka zbatuar vendimin Nr. 1028/2024, datë 12.08.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit publik "E hapur, e thjeshtuar", me Nr. REF-09064-06-11-2024, me objekt: **"Loti I "Materiale Kancelarie me bazë letre" "**, me fond limit 736,606.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 12.06.2024, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

